

PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE SHKENCORE PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018 NË DEPARTAMENTIN E FARMACISË NË ALBANIAN UNIVERSITY

**Përgjegjëse e Departamentit
Dr. Dorina Dervishi**

Veprimtaria kërkimore shkencore për vitin akademik 2017-2018:

- Për vitin akademik 2017-2018 Departamenti i Farmacisë planifikon të zhvillojë **Konferencën e 8-të studentore** në bashkëpunim me studentët e programit të studimit Farmaci dhe me pjesëmarrjen e pedagogëve të disiplinave të ndryshme. Kjo konferencë parashikohet të mbahet në javën e parë të muajit Shkurt 2018.

Tematikat synojnë të vendosin në fokus risitë shkencore që ndeshen në të gjitha disiplinat e formimit profesional të farmacistit, ku mund të veçojmë: teknologjia e përgatitjes së barnave, kontrolli i cilësisë së barnave, analiza e lëndëve helmuese (analiza toksikologjike), kontrolli i cilësisë së bimëve mjekësore e aromatike etj. Konferenca Studentore do të zhvillohet në ambientet e sallës së konferencave, pranë godinës së Estradës.

- Ashtu si çdo vit Departamenti i Farmacisë do të organizojë **Konferencën e IV-t Ndërkombëtare Farmaceutike në bashkëpunim me Universitetin e Pizës, Universitetin e Napolit, Itali dhe Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë në muajin Mars 2018.**

Në Konferencë parashikohet të marrin pjesë dhe të referojnë profesionistë të fushës farmaceutike dhe mjekësore, akademikë, profesorë dhe kërkues të huaj pjesë e Universiteteve bashkëpunues me Universitetin tonë.

Nisur nga eksperiencia e viteve të kaluara parashikojmë që konferenca Ndërkombëtare edhe për këtë vit të zhvillohet në ambientet e Tirana International Hotel & Conference Center.

- Gjatë javës së sensibilizimit mbi përdorimin e antibiotikëve në data

13- 19 Nëntor 2017, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, Fakultetin e Mjekësisë,

Departamentin e Farmacisë, do të organizojnë aktivitete të ndryshme të cilat kanë lidhje me **dhënien e mesazheve sensibilizuese lidhur me përdorimin e antibiotikëve.**

- Gjithashtu për vitin akademik 2017-2018 parashikohet të mbahen:

workshope, leksione të hapura, si dhe trajnime dhe seminare me tematika aktuale në fushën e shëndetësisë si për stafin akademik ashtu edhe për studentët e viteve të fundit të programit të studimit Master i Shkencave në Farmaci, me pjesëmarrjen e profesorëve me aktivitet të pasur kërkimor shkencor.